

ANEKSI NR. 5

**MINUTAT E TAKIMIT ME SHOQËRINË CIVILE TË
MINISTRIVE TË LINJËS PËR PBA 2026-2028**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

MINUTA TAKIMI

Për takimin e zhvilluar në datën 28.04.2025

Konsultimi mbi hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026–2028 dhe procedurat e financimit të OJF-ve për ofrimin e Ndhmës Juridike Parësore

Në datën 28 Prill 2025, në ambientet e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas (DNJF), u zhvillua një tryezë konsultative në kuadër të zbatimit të Udhëzimit plotësues nr. 7, datë 28.02.2025, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026–2028”.

Takimi kishte për qëllim të angazhonte organizatat jofitimprurëse të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore në një proces dialogu dhe reflektimi mbi nevojat buxhetore, problematikat në procesin e financimit, si dhe propozimet për përmirësime në praktikat aktuale të bashkëpunimit ndërmjet DNJF-së dhe OJF-ve. Takimi u hap me një fjalë hyrëse nga përfaqësues të DNJF-së, të cilët falënderuan organizatat pjesëmarrëse për angazhimin dhe vlerësuan rolin e tyre të rëndësishëm në ofrimin e ndihmës juridike për shtresat në nevojë. U theksua rëndësia e këtij bashkëpunimi për garantimin e të drejtave themelore të qytetarëve dhe domosdoshmëria e përmirësimit të mekanizmave të financimit.

Çështjet që u diskutuan

1. Gjendja aktuale e financimit të OJF-ve nga DNJF

DNJF bëri një përmbledhje të shkurtër të situatës aktuale lidhur me financimin e OJF-ve të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore:

- Financimi i OJF-ve nisi për herë të parë në vitin 2023, ku u shpallën fituese 2 organizata.
- Në vitin 2025 numri i organizatave fituese u rrit në 4, duke reflektuar një përmirësim në pjesëmarrje dhe interes.
- Fondi i planifikuar prej 8,000,000 lekësh ka qenë i mjaftueshëm për të mbuluar nevojat dhe për këtë arsye nuk është parashikuar ndryshim në buxhet për vitin në vazhdim.
- U theksua se megjithëse janë të autorizuar 14 OJF, vetëm 7 aplikuan për financim, çka ngre shqetësime lidhur me nivelin e ndërgjegjësimit apo kapacitetet administrative për aplikim.

Përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë vunë në dukje se edhe në të kaluarën ka pasur tepriçë fondesh dhe ndoshta interesi i ulët i OJF-ve kërkon analiza të mëtejshme.

2. Sugjerime nga OJF-të pjesëmarrëse për strukturën e financimit

Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza:

- Pasi falënderuan për ftesën, përfaqësuesit e kësaj organizate theksuan nevojën për përfshirjen në projektin e financimit edhe të një punonjësi administrativ part-time për të menaxhuar raportimet, deklaratimet dhe komunikimet me institucionet, pasi këto detyra janë të vështira për t'u përballuar nga juristi i vetëm.

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS):

- Pavarësisht se është hera e parë që përfitojnë financim, ndanë të njëjtin shqetësim me organizatën paraqolëse. Roli i juristit është tejet i ngarkuar dhe nuk mund të mbulojë edhe detyra administrative dhe raportuese, të cilat kërkojnë një person të dedikuar, të paktën pjesërisht.

Qëndrimi i DNJF-së:

- U sqarua se financimi i ofruar nga DNJF është i kufizuar dhe aktualisht mbulon vetëm kontraktimin e një juristi për ndihmë juridike parësore.
- Theksoi se kjo praktikë është në përputhje me mënyrën e funksionimit të qendrave të DNJF-së, ku një specialist jurist ofron ndihmë juridike dhe shpesh herë angazhohet edhe në aktivitete ndërgjegjëse.

3. Çështja e barazisë në financim dhe procedurat e aplikimit

Forumi i Gruas Elbasan:

- Propozoi që të gjitha OJF-të e autorizuar të përfitojnë automatikisht financim dhe që procesi të mos kalojë përmes aplikimeve të ndara me projekt.

Qëndrimi i DNJF-së:

- U theksua se procesi i autorizimit është krejtësisht i ndarë nga procesi i financimit.
- Çdo organizatë, për të përfituar financim, duhet të paraqesë një projekt konkret dhe të përmbushë kriteret e përcaktuara në VKM-në përkatëse.
- Gjithashtu, nëse një organizatë ka një financim të ngjashëm nga një donator tjetër për të njëjtin qëllim, ajo nuk mund të përfitojë financim të dyfishtë nga DNJF.

- DNJF nënvizoi se ka lehtësuar ndjeshëm procedurat këtë vit, duke ndihmuar organizatat edhe me pjesë të dokumentacionit të kërkuar.

4. Propozimi për hapjen e një thirrjeje të dytë vjetore

Organizata “Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare Berat”:

- Parashtruan shqetësimin se për arsye teknike nuk arritën të përfundojnë aplikimin këtë vit dhe sugjeruan që të hapet një thirrje e dytë brenda të njëjtit vit buxhetor.

Qëndrimi i DNJF-së:

- DNJF e konsideroi këtë si një mundësi të vlefshme, veçanërisht për zonat ku nuk ka prezencë të qendrave të ndihmës juridike dhe ku pjesëmarrja është më e ulët.
- U përmend mundësia për hapjen e një thirrjeje të dytë të fokusuar, për shembull, në qytete si Saranda, për të mbuluar më mirë gjithë territorin e vendit.

5. Vështirësitë për zbatimin e projekteve në qytete ku nuk ka seli

Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza dhe TLAS ngritën shqetësimin se:

- Është e vështirë të angazhohen punonjës në qytete të tjera pa pasur seli aty.
- Ka sfida të mëdha për mbikëqyrjen e stafit dhe kosto shtesë për menaxhimin e projektit, duke përfshirë udhëtime, logjistikë dhe koordinim.

Përfundime

Tryeza konsultative e datës 28 Prill 2025 shërbeu si një platformë e vlefshme dialogu ndërmjet DNJF-së dhe organizatave jofitimprurëse të autorizuar, duke evidentuar sfidat aktuale dhe nevojat për përmirësim të mëtejshëm në strukturën dhe procedurat e financimit. Nga diskutimet u nxorën disa rekomandime kryesore:

1. **Forcimi i kapaciteteve të OJF-ve për aplikim dhe zbatim** – U pa si e nevojshme ofrimi i më shumë mbështetje teknike për organizatat, sidomos për ato më të vogla apo që operojnë në qytete të vogla dhe më pak të mbuluara.
2. **Analiza e mundësive për rritje fondesh në të ardhmen** – Edhe pse aktualisht fondi është i mjaftueshëm, u ngrit nevoja për rishikim të mundshëm të buxhetit në rast se rritet interesi dhe përfshirja e organizatave, veçanërisht në zona ku mungojnë shërbime juridike.

3. **Promovimi i barazisë në qasjen në financim** – DNJF do të shqyrtojë më tej mekanizmat për të siguruar që të gjitha OJF-të e autorizuar të kenë mundësi të barabarta për të konkurruar, duke shmangur pengesat procedurale apo mungesën e informacionit.
4. **Konsiderimi i një thirrjeje të dytë vjetore** – Si një mjet për të siguruar fleksibilitet dhe për të mundësuar përfshirjen e organizatave që nuk arrijnë të aplikojnë në thirrjen e parë.
5. **Ngritja e një rrjeti bashkëpunimi ndërinstitutional dhe ndër-OJF** – U sugjerua që të zhvillohen më shpesh takime të ngjashme, ku organizatat të ndajnë përvoja, sfida dhe praktika të mira, për të përmirësuar cilësinë dhe impaktin e ndihmës juridike.

Takimi u mbyll në një frymë bashkëpunuese, me mirëkuptim të ndërsjellë dhe me pritshmëri pozitive për përmirësime konkrete në proceset e ardhshme të financimit dhe implementimit të ndihmës juridike falas.

DNJF shprehu angazhimin për të vazhduar të jetë një partner aktiv në mbështetje të organizatave dhe për garantimin e aksesit të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

MINUTA TAKIMI

Për takimin e zhvilluar në datën 22.04.2025

Në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, më datë 22.04.2025 u zhvillua një takim konsultativ midis përfaqësuesve të Qendrës Europiane, Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte shqyrtimi i sfidave dhe mundësive lidhur me rritjen dhe menaxhimin e buxhetit të dedikuar për programin e ndihmës juridike falas, si dhe diskutimi mbi masat për përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Takimi shërbeu si një platformë e rëndësishme dialogu për të adresuar shqetësimet e ngritura nga Qendra Europiane lidhur me kapacitetet financiare dhe organizative të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, si dhe për të identifikuar hapat e nevojshëm për një zbatim më efektiv të PBA-së në periudhën 2026-2028.

Qendra Europiane shprehu shqetësimin e saj lidhur me nivelin e rritjes së buxhetit të ndihmës juridike, duke theksuar se përqindja e shtuar është shumë e ulët dhe nuk reflekton nevojat reale të programit. U theksua rëndësia e një financimi adekuat për të garantuar që shërbimet e ndihmës juridike të jenë të qasshme, cilësore dhe në përputhje me standardet europiane. Përfaqësuesit e Qendrës kërkuar vëmendje më të madhe ndaj sfidave financiare që ndikonin në zbatimin e detyrave të drejtorisë, duke sugjeruar shqyrtimin e mundësive për një mbështetje më të madhe buxhetore në vitet e ardhshme.

Në përgjigje të këtyre shqetësimeve, Ministria e Drejtësisë sqaroi se, përkundër rritjes së kufizuar të buxhetit, shërbimet e ndihmës juridike parësore dhe dytësore janë ofruar në mënyrë të pandërprerë dhe pa ndonjë ndikim negativ në cilësinë apo kohëzgjatjen e tyre. U theksua se fondet e alokuara nuk janë shpenzuar plotësisht dhe pjesa e mbetur është raportuar si fonde të lira në fund të vitit, duke reflektuar një menaxhim të kujdesshëm dhe efikas të burimeve financiare. Ministria theksoi gjithashtu nevojën për një analizë më të detajuar të strukturës së shpenzimeve për të identifikuar mundësitë e përmirësimit dhe optimizimit të përdorimit të buxhetit ekzistues.

Qendra Europiane theksoi rëndësinë e shtimit të kapaciteteve njerëzore në Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas për të përballuar ngarkesën në rritje të punës dhe për të siguruar një shërbim më efektiv dhe të gjithanshëm. Në këtë kuadër, përfaqësuesit e Drejtorisë informuan se gjatë fillimit të vitit 2025 është miratuar struktura e re organizative e Drejtorisë, e cila përfshin edhe shtimin e numrit të punonjësve me përvojë dhe kompetenca të specializuara, në përputhje me nevojat

operative dhe strategjinë zhvillimore të institucionit. Kjo masë synon të rrisë kapacitetin institucional dhe të përmirësojë përgjegjshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve juridike falas.

Nga ana e Qendrës Europiane u evidentua një shqetësim lidhur me efikasitetin e ofrimit të Ndhmës Juridike Dytësore, duke theksuar nevojën për një mënyrë më fleksibile të pagesave ndaj avokatëve që angazhohen në këtë shërbim. Konkretisht, u propozua që pagesat të kryhen në këste, me qëllim përmirësimin e menaxhimit financiar dhe incentivimin e ofrimit të shërbimeve në kohë. Përfaqësuesit e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas shpjeguan se, për shkak të rregulloreve ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi, pagesat paraprake nuk mund të realizohen, duke theksuar rëndësinë e respektimit të kuadrit ligjor aktual dhe transparencës financiare në procesin e financimit të avokatëve.

Në përfundim të këtij takimi, të gjithë pjesëmarrësit ranë dakord mbi rëndësinë e adresimit të sfidave të ngritura gjatë diskutimeve, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve të Ndhmës Juridike Falas dhe optimizimin e përdorimit të burimeve financiare në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028.

U theksua nevoja për vijim të dialogut dhe bashkëpunimit të ngushtë midis institucioneve përkatëse, në mënyrë që të sigurohet zbatimi efikas dhe i qëndrueshëm i objektivave të përcaktuara. Pjesëmarrësit shprehën gatishmërinë për të punuar së bashku në realizimin e rekomandimeve të diskutuar dhe monitorimin e progresit në periudhën në vijim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

MINUTA TAKIMI

Për takimin e zhvilluar në datën 30.04.2025

Mbi diskutimet e zhvilluara gjatë konsultimit për Projekt-Buxhetin Afatmesëm (PBA) 2026–2028 për Sistemin e Burgjeve

Në datën 30.04.2025, u zhvillua konsultimi për Projekt-Buxhetin Afatmesëm 2026–2028 për Sistemin e Burgjeve, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë, Sindikatat e Policisë së Burgjeve dhe përfaqësues nga Zyra e Avokatit të Popullit. Ky takim kishte si qëllim diskutimin e nevojave financiare dhe operacional të sistemit penitenciar, me fokus në përmirësimin e kushteve të punës dhe mbështetjen e stafit policor dhe administrativ.

Gjatë procesit të konsultimit për PBA 2026–2028 për Sistemin e Burgjeve, janë evidentuar disa çështje thelbësore që kërkojnë adresim të menjëhershëm dhe planifikim buxhetor të qëndrueshëm. Këto çështje lidhen drejtpërdrejt me përmirësimin e kushteve të punës dhe mbështetjen për efektivitetin operacional të stafit policor dhe administrativ brenda sistemit penitenciar.

1. Shtesat për punonjësit e kuzhinës

Është ngritur shqetësimi për mungesën e dy shtesave për vështirësi pune për punonjësit e kuzhinës. Këto shtesa, ndonëse të justifikuara nga natyra e veçantë e detyrës, nuk janë dhënë deri më tani nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Kërkohej që këto pagesa të parashikohen dhe të fillojnë zbatimin brenda vitit 2026.

2. Pagesat e prapambetura për stafin policor

Si pasojë e vonesave në miratimin dhe zbatimin e ndryshimeve strukturore në kuadër të ligjit nr. 20/2020 “Për Policinë e Burgjeve”, nuk janë ekzekutuar pagesat përkatëse për një periudhë të stafit policor. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka parashikuar përfshirjen e këtij fondi në buxhetin e vitit 2025, me qëllim normalizimin e situatës.

3. Ushqimi për policinë gjatë shoqërimit të të dënuarve

U trajtua çështja e mungesës së mbulimit ushqimor për punonjësit që kryejnë detyrën e shoqërimit të të burgosurve, përtej dietave dhe pagesave për orët shtesë. Kjo përbën një boshllëk

në mbështetjen logjistike për këtë kategori punonjësish dhe kërkon përfshirje të posaçme në planifikimin buxhetor.

4. Ushqimi për punonjësit që punojnë larg vendbanimit

Një tjetër problematike e nënvizuar ishte mungesa e mbështetjes për ushqimin e punonjësve që ushtrojnë detyrën në institucione të ndodhura jashtë vendbanimit të tyre. Kjo kategori has në vështirësi të përditshëm dhe nevojitet një mekanizëm kompensues i qartë dhe i strukturuar.

5. Uniformat sipas standardeve

Në dokumentin e PBA-së 2026–2028, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka paraqitur një kërkesë për fonde shtesë për sigurimin e uniformave për stafin, sipas standardeve bashkëkohore të shërbimit dhe funksioneve të kryera. Kjo kërkesë mbështetet për shkak të konsumit të lartë të pajisjeve të uniformës dhe nevojës për një paraqitje profesionale dhe të unifikuar të efektivëve.

PËRFUNDIMI

Në bazë të diskutimeve të zhvilluara dhe analizës së nevojave reale të Sistemit të Burgjeve, është vendosur që:

- Shtesat për vështirësi pune për punonjësit e kuzhinës do të përfshihen dhe zbatohen në Projekt-Buxhetin Afatmesëm 2026–2028, me fillim nga viti 2026, duke respektuar legjislacionin në fuqi për shtesat dhe kushtet e punës.
- Pagesat e prapambetura për stafin policor do të ekzekutohen plotësisht dhe pa vonesa gjatë vitit 2025.
- Do të hartohet dhe implementohet një politikë e posaçme për sigurimin e ushqimit për punonjësit gjatë shoqërimit të të dënuarve dhe për ata që ushtrojnë detyrën jashtë vendbanimit.
- Fondet për uniformat sipas standardeve bashkëkohore do të akordohen dhe shpenzohen në përputhje me nevojat reale të stafit.

Këto masa do të përmirësojnë ndjeshëm kushtet e punës dhe performancën e përgjithshme të sistemit penitenciar.

Minutat e Takimit

Mbledhja e Grupit Ndërinstitucional për Projekt Buxhetin 2026-2028

E Mërkurë / 30 Prill 2025

Vendi: Salla e Mbledhjeve / MSHMS

Në datë 30 Prill 2025, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zhvilloi takimin e parë për Projekt Buxhetin 2026 – 2028.

Takimi u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile, si dhe institucioneve të tjera relevante. Nga shoqëria civile ishin prezent në takim përfaqësues të Shoqatave: “Together for Life”, “Klubi i Prindërve për Autizimin”, “Ndihmoni Jetën”, “Alo 116111”, “Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë”, “Global Care Albania”, “Shoqata kombëtare Shqipatre e Njerëzve që nuk Dëgjojnë”, “Qendra Kombëtare për Studime Sociale”, “Autizimi flet”.

Diskutimet u përqendruan në problematika të shumta që lidhen me aksesin dhe cilësinë e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, me një vëmendje të veçantë ndaj personave me spektrin e autizmit dhe atyre mbi moshën 21 vjeç.

Fjala përshëndetëse dhe hapëse e takimit u mbajt nga **Znj. Jona Dervishaliaj**, *Drejtores e Përgjithshme e Zhvillimit për Mbrojtjen Sociale* dhe **Znj. Mejvis Bajollari**, *Drejtores e Përgjithshme e Shëndetësisë*, të cilat falenderuan të gjithë anëtarët e shoqërisë civile për prezencën e tyre në këtë takim.

Në hapje të diskutimit, **Znj. Eglantina Bajrami**, *Klubi i Prindërve për Autizmin*, theksoi mungesën e shërbimeve të përshtatura për personat me probleme të dëgjimit në ambulancë dhe spitale, ku u soll në vëmendje rasti i një vajze që qëndroi dy javë në spital dhe që mundi të asistohet vetëm përmes ndërhyrjes me telefonatë nga zyra, për shkak të mungesës së interpretëve ose ndihmës së specializuar. Pavarësisht ekzistencës së marrëveshjeve me institucione të ndryshme, ndjehet mungesa e një përfshirjeje aktive për të ofruar mbështetje në gjendjen psikosociale të personave me aftësi të kufizuara.

Znj. Bajrami gjithashtu shprehu se në fushën e shërbimeve shëndetësore, një tjetër problem i rëndësishëm ishte mungesa e ndërhyrjeve të përshtatshme stomatologjike dhe kostot e larta të anestezisë, të cilat përbëjnë një barrë të rëndë për familjet. Në këtë kuadër, përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile kanë propozuar një projekt konkret për krijimin e një salle kirurgjikale me një kosto prej 35,000 eurosh.

Znj. Afërdita Seiti, *Shoqata “Ndihmoni Jetën”*, pergjate diskutimit vendos ne vemendje mungesën e zgjidhjeve afatgjata për personat mbi 40-50 vjeç pa kujdestarë, të cilët shpesh izoloohen nga familjarët për shkak të sjelljeve agresive ose mungesës së strukturave të përshtatshme. U vu në dukje nevoja për krijimin e qendrave rezidenciale për persona mbi 30 vjeç, të përshtatura sipas

rasteve individuale. Megjithëse disa modele janë pilotuar, ato nuk janë financuar dhe nuk janë zbatuar në praktikë. Si alternativë, u konsiderua me vlerë krijimi i apartamenteve të vogla me ndihmës personal, me qëllim ofrimin e një mbështetjeje të qëndrueshme dhe dinjitoze.

Një tjetër problem madhor që u ngrit prej **Znj. Seiti**, ishte mungesa e statusit ligjor të kujdestarisë për një pjesë të madhe të prindërve të fëmijëve me autizëm, gjë që i privon ata nga ndihma ekonomike dhe aksesimi i shërbimeve. Në këtë kontekst, u kërkua rishikimi i ligjit ekzistues për të garantuar shërbime të përshtatura për grupmoshën përkatëse, si dhe ndarjen e qendrave të zhvillimit sipas grupmoshave.

Rastet e rënda të fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara, të cilat nuk mund të përballohen nga familjet, kërkojnë ndërhyrje urgjente. Shoqëria civile rekomandoi zhvillimin e shërbimeve të ndërmjetme, si qendrat ditore, strukturat e vogla rezidenciale dhe kujdesi profesional i përkohshëm (foster care), përpara se të ndërmerret mbyllja e institucioneve ekzistuese.

Znj. Xhilda Papajani dhe Znj. Nertila Topulli, *Drejtoria e Politikave të Perkuqjesjes Sociale dhe Shërbimeve Sociale të Integruara*, sqaruan se financimi i shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara do të realizohet nga buxheti i shtetit. U theksua rëndësia e përfshirjes së këtyre shërbimeve në planet buxhetore ekzistuese dhe siguruan pjesëmarrësit se mbështetja financiare për shërbimet sociale do të vazhdojë të jetë prioritet në politikat e Ministrisë.

Përveç kësaj, **Z. Jonid Ferhati**, *Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë*, diskutoi mungesën e punësimit të qëndrueshëm për personat me aftësi të kufizuara, të cilët shpesh punësohen përkohësisht në projekte dhe më pas largohen nga puna. Kjo situatë ka pasoja psikologjike dhe rrit ndjesinë e përjashtimit social. Për të adresuar këtë problem, u kërkua ofrimi i trajnimeve të përshtatura dhe zhvillimi i formave alternative të punësimit, si ndërmarrjet sociale. Gjendja e kujdestarëve familjarë u vlerësua gjithashtu si shqetësuese, pasi pagesat për ta janë minimale dhe shumë persona me aftësi të kufizuara mbeten të vetmuar dhe pa mbështetje.

Nga ana e shoqërisë civile u kërkua rritja e transparencës në planifikimin dhe shpërndarjen e buxheteve për shërbimet sociale, me theks të veçantë në sigurimin e një buxheti të dedikuar për këtë shërbim, i cili aktualisht mungon. U theksua nevoja për përmirësimin e kushteve të punës për infermierët nëpërmjet shërbimeve, vecanërisht në lidhje me materialet e punës. U theksua rëndësia e buxhetimit të saktë dhe të detajuar për çdo shërbim individualisht.

Znj. Bajollari, dha disa sqarime dhe komente të rëndësishme në lidhje me zhvillimet aktuale dhe sfidat në ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara. Më tej, ajo nënvizoi rëndësinë e zgjerimit të shërbimeve në komunitet dhe jo vetëm në qendrat rezidenciale, si dhe nevojën për të përmirësuar paketën e kujdesit në banesë.

Znj. Dervishaliaj, e mbështeti plotësisht shqetësimet e ngritura nga pjesëmarrësit, duke i konsideruar si çështje me prioritet të lartë që duhet të avancohen. Ajo njoftoi se ka nisur procesin e rishikimit të Ligjit nr. 121 për shërbimet për personat me aftësi të kufizuara mbi moshën 21 vjeç. Në këtë kuadër, u shpreh se secili prej përfaqësuesve të shoqërisë civile do të përfshihet në

mënyrë aktive në procesin e ristrukturimit të shërbimeve, për të siguruar që politikat e reja të përmbushin nevojat reale të kësaj kategorie.

Pjesëmarrësit ranë dakord se problematikat e ngritura kërkojnë adresim të menjëhershëm dhe veprime konkrete nga institucionet përkatëse. U propozua organizimi i një takimi të dytë për të diskutuar hapat e mëtejshëm dhe për të ndarë praktikat më të mira evropiane në zbatim të modeleve të kujdesit dhe përfshirjes sociale. Po ashtu, u nënvizua nevoja për një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile për hartimin e politikave të qëndrueshme dhe për adresimin me përparësi të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.